

PËRMIRËSIMI I ROLIT TË KUVENDIT NË LIGJBËRJEN DHE MBIKQYRJEN E FINANCIMEVE TË PALIGJSHME NË SHQIPËRI

(DOKUMENT PUNE)

Janar, 2024

Të gjitha të drejtat për këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtimeve	4
Përmbledhje ekzekutive.....	5
1. Hyrje.....	7
2. Metodologjia	7
3. Financimet e paligjshme në Shqipëri	16
3.1 Konsiderata të Përgjithshme	16
3.2 Analiza e Hapësirave Eventuale për Korrupsion.....	18
3.3 Disa komente specifike në lidhje me përmbajtjen e draft-ligjit.....	20
4. Roli i aktorëve të sistemit parlamentar në mbikqyrjen efektive të fushës së financimeve të paligjshme në Shqipëri	26
5. Konkluzione dhe Rekomandime	30
Bibliografia.....	32

Lista e figurave

Figura 1: Kategoritë e kritereve për vlerësim të hapësirave korruptive	18
--	----

Lista e shkurtimeve

AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AML	Standardi global kundër pastrimit të parave
BE	Bashkimi Evropian
CFT	Standardi global kundër financimit të terrorizmit
CSO	Organizatat e shoqërisë civile
FATF	Task Forca e Veprimit Financiar
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PFP	Prurjet Financiare të Paligjshme
WFD	Fondacioni Westminster për Demokraci

Përmbledhje ekzekutive

Ky dokument analizon financimet e paligjshme në Shqipëri, fokusuar në një analizë të thelluar ligjore të projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015, 'Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë'", i ndryshuar, si dhe analizës së ligjit nr. 66/2023 "Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara", i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me datën 20.07.2023. Kjo analizë është zhvilluar duke u mbështetur në kriteret specifike të vlerësimit të hapësirave eventuale për korrupsion, të cilat i gjeni të shpjeguara në vijim të këtij dokumenti.

Në analizën tonë të projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/2015, 'Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë'", i ndryshuar, hasim disa çështje thelbësore:

- Projektligji nuk ofron shpjegime të mjaftueshme rreth subjekteve të licencuara për lojërat e fatit, veprimtarisë së tyre, dhe impaktit në shoqëri. Kjo bën që të mungojë një përshkrim faktik dhe i qartë i situatës së subjekteve që operojnë sipas këtij ligji dhe licencave të tyre.
- Mungesa e një analize sociale në projektligj dhe mos-konsultimi me grupet e vulnerabël, të cilat janë prekur nga varësia e lojërave të fatit, shkaktojnë dyshime rreth përshatshmërisë së këtij projekti. Ky aspekt është thelbësor pasi lojërat e fatit u mbyllën në vitin 2018 me argumentin e parandalimit të pasojave sociale në shoqërinë shqiptare.
- Projektligji përqendrohet në parandalimin e pastrimit të parave në fushën e lojërave të fatit, por nuk ofron informacion mbi raportet e brendshme të organeve përgjegjëse ose të organeve të huaja për pastrim parash në këtë sektor.
- Kriteret për subjektet aplikuese për licencë të basteve sportive online janë të ngurta dhe subjektive, duke kufizuar konkurrencën dhe duke rritur mundësinë e paracaktimit të subjekteve të licencuara. Kjo mund të shkaktojë mungesë konkurrence në treg dhe krijon dilema për kriteret subjektive.
- Lejimi për subjektet e licencuara për lojërat e fatit të sponsorizojnë skuadra sportive dhe të bëjnë publicitet të aktiviteteve të tyre rrit mundësinë për trukim të ndeshjeve dhe organizim të basteve mashtruese.

Në lidhje me ligjin nr. 66/2023 "Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara", i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me datën 20. 07. 2023, po rendisim disa konstatime nga analiza e detajuar e dokumenteve të publikuara:

- Ligji, siç shpjegohet në relacionin¹ e tij shoqëruar, përcakton rregulla për ndërtimet pa leje të konfiskuara, duke u bazuar në parashikimet e ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Megjithatë, këto rregulla mund të jenë më mirë të integruara në ligjin ekzistues, siç është ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në vend që të krijohet një ligj i ri.

¹ Faqe zyrtare e Kuvendit të Shqipërisë, <https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/11791441-855b-4d61-a1aa-9ef28190ac7a>.

- Ligji duket se nuk i jep zgjidhje të qarta disa çështjeve të rëndësishme, përfshirë: Kriteret për të vendosur nëse një ndërtim pa leje ose shtesë në volum ose sipërfaqe duhet të prishet ose të konfiskohet; Përkatësia e prishjes së shtesave pa leje me qëndrueshmërinë e ndërtesës, pasi shpeshherë është çështje e preferencave të qytetarëve për më pak ndërtime në qytet; Shkalla e largësisë që duhet të mbahet midis ndërtimeve pa leje.
- Në thelb, ky ligj duket se është i orientuar drejt legalizimit të ndërtimeve pa leje, të cilat janë konceptuar si shtesa në volum ose sipërfaqe në një godinë të re të ndërtuar me leje ndërtimi. Kjo i jep shoqërive ndërtuese mundësinë t'i blejnë këto ndërtime pa leje nga shteti.
- ipërfaqe në një godinë të re të ndërtuar me leje ndërtimi. Kjo i jep shoqërive ndërtuese mundësinë t'i blejnë këto ndërtime pa leje nga shteti.
- Ligji duket se është në përputhje me ligjin Nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin ndërtimeve pa leje" të ndryshuar, dhe trajton ndërtime pa leje të cilat janë ndërtuar deri më datën 27.06.2014. Pra, ky ligj i ri legalizon ndërtime dhe shtesat pa leje, që kanë mbijetuar pa u prishur ose që janë ndërtuar në 10-vjeçarin e fundit, apo që pritet të ndërtohen në të ardhmen.

1. Hyrje

Situata e financimeve të paligjshme në Shqipëri ka qenë dhe vazhdon të jetë një sfidë e madhe për ekonominë dhe rendin ligjor të vendit. Kjo përfshin një gamë të gjerë të aktiviteteve të paligjshme, të cilat përfshijnë evazionin fiskal, shpërdorimin e fondeve publike, pastrimin e parave, kontrabandën, dhe aktivitetet e tjera të paligjshme të cilat kanë ndikim të madh në ekonominë e vendit dhe besimin në institucionet shtetërore. Ky dokument pune ka si qëllim që të paraqesë një analizë të thelluar të projekt ligjit/ve që lidhen në mënyrë direkte dhe/ose indirekte me financimet e paligjshme në vend, me synimin e identifikimit të hapësirave korruptive. Me konkretisht, dokumenti i punës analizon projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/ 2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 66/ 2023 “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me datën 20. 07. 2023.

Në fund, dokumenti vjen me disa propozime konkrete me qëllim përmirësimin e rolit ligjbërës dhe mbikqyrës të Kuvendit, në fushën e financimeve të paligjshme.

2. Metodologjia

2.1 Analiza e studimeve ekzistuese

Prurjet Financiare të Paligjshme (PFP), të përcaktuara si “*prurje financiare që janë të paligjshme në origjinë, transferim ose përdorim, që pasqyrojnë një shkëmbim vlerash dhe që kalojnë kufijtë e vendeve*”² dhe janë pasojë e veprimeve kriminale, korrupsionit apo evazionit fiskal, paraqesin një sfidë të rëndësishme për vendet e Ballkanit Perëndimor. Sipas studimeve dhe evidencave, faktorët kryesorë që nxisin përhapjen e PFP përfshijnë shkalla e lartë e informalitetit në ekonomi, që llogaritet se përfaqëson 30–40 për qind të ekonomisë si dhe dobësia e përgjithshme e shtetit, institucioneve shtetërore dhe kulturës demokratike.³

Në Shqipëri, PFP shfaqet në disa dimensione. Trafikimi i drogës është aktiviteti më fitimprurës për grupet kriminale në 30 vitet e fundit. Korrupsioni dhe vjedhjet e fondeve publike janë një burim tjetër i madh i fitimeve të paligjshme në Shqipëri, duke humbur 300 milionë euro çdo vit nga abuzimet me procedurat e prokurimeve publike, që përfaqësojnë afërsisht 45% të kontratave publike të vitit 2019. Krimi ekonomik dhe evazoni fiskal janë po ashtu probleme të mëdha, me shumicën e disnivelit midis të ardhurave nga tregtia dhe rezervave të këmbimit valutor atribuar manipulimit të mallrave dhe shërbimeve që hyjnë në vend. Pjesa e madhe e

² Këshilli Ekonomik dhe Social. (2022). Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Statistikat e Krimit. Marrë nga <https://unstats.un.org/unsd/statcom/53rd-session/documents/2022-14-CrimeStats-E.pdf>

³ Iniciativa Globale. (2020). Prurje financiare të paligjshme në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut: Faktorët Kryesorë dhe Prirjet Aktuale. Marrë nga <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/08/Prurje-Financiare-Te%CC%88-Paligjshme-Ne%CC%88-Shqipe%CC%88ri-Kosove%CC%88-Dhe-Maqedonine%CC%88-E-Veriut-Faktore%CC%88t-Kryesore%CC%88-Dhe-Prirjet-Aktuale.pdf>.

këtyre fitimeve të paligjshme transferohen brenda dhe jashtë vendit përmes transportimit të parave të thata, që mbetet metoda më e zakonshme e lëvizjes së vlerave monetare.⁴

Shqetësues janë financimet e paligjshme shihen më së shumti në sektorë të veçantë të ekonomisë si për shembull ndërtimi. Sipas raportit të fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit, shihet se Shqipëria ka rreth 440,000 ndërtesa të paligjshme, të cilat janë ndërtuar pa leje. Kjo situatë e ndërtimit të paligjshëm është një problem i madh për sigurimin e titujve të pronësisë. Një proces është nisur në vitin 2006 për të legalizuar ose eliminuar këto ndërtesa, por ende nuk është përfunduar. Sipas të dhënave më të fundit, deri në fund të vitit 2020, janë lëshuar rreth 200,000 leje legalizimi.⁵

Nga ana tjetër, komuniteti i biznesit raporton se fluksi i madh i të ardhurave të paligjshme nga trafikimi i drogës, kontrabanda, evazioni fiskal dhe korrupsioni përkeqëson konkurrencën në treg.⁶ Financimet e paligjshme paraqesin shqetësime edhe për organizatat e shoqërisë civile, të cilët janë bashkuar dhe kanë ndërtuar një udhëzues praktik “Guide 2023”⁷ i cili ka si qëllim të ndihmojë në parandalimin e abuzimit dhe mundësinë e abuzimit të organizatave për pastrim parash dhe financim të terrorizmit. Udhëzuesi është përpiluar në një mënyrë të thjeshtë dhe miqësore për përdoruesin, pa nevojën për ndihmën ose shërbimin e një eksperti ligjor.

2.2 Analizë e legjislacionit primar dhe sekondar në fushën e financimeve të paligjshme

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21. 10. 1998, i ndryshuar, mishëron në të parimin e kushtetueshmërisë dhe të ligjshëmërisë. Në nenin 4, pika 1, të saj parashikohet se: “E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit”, ndërsa në nenin 5 parashikohet se: “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.”. Këto dy dispozita, në unitet edhe me parashikimet e tjera kushtetuese, sanksionojnë parimin e ligjshëmërisë, si një nga parimet themelore të funksionimit të shtetit shqiptar.

Po ashtu, në nenin 9, pikat 1 dhe 3 të Kushtetutës parashikohet se: “1. Partitë politike krijohen lirisht. 2. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike. 3. Burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike.” Në Kushtetutë i kushtohet një dispozitë e posaçme partive politike dhe mënyrës së tyre të financimit, pasi dihet se institucionet kryesore në vend rrjedhin nga zgjedhjet politike, ku partitë luajnë rol të dorës së parë. Çdo financim i paligjshëm i partive politike, i zgjedhjeve politike apo administrative në vend, është prelude i një vendimmarrjeje shtetërore në konflikt interesi, që deformon konkurrencën dhe vë në rrezik shumëherë edhe sigurinë kombëtare.

⁴ Ibid.

⁵ Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. (2023). Deklaratë e Klimës së Investimeve. Marrë nga <https://www.state.gov/reports/2023-investment-climate-statements/albania/>.

⁶ Ibid.

⁷ Partners Albania. (2023). Guide 2023. Marrë nga <https://www.partnersalbania.org/wp-content/uploads/2023/09/guide-2023.pdf>.

Konventa Europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit” është ratifikuar me ligjin nr. 8646, datë 20. 7. 2000 dhe parashikon në të terminologjinë në këtë fushë, masat që duhen marrë në shkallë kombëtare nga shtetet palë, elementët që përfshihen te vepra e pastrimit të parave, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar mes vetë shteteve palë.

Konventa Penale për korrupsionin është ratifikuar me ligjin nr. 8778, datë 26. 04. 2001. Në nenin 13 të saj parashikohet ndër të tjera se: “Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative, dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, sjelljen e referuar në Konventën e Këshillit të Europës për pastrimin, kërkimin, marrjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit (Seria e traktateve evropiane nr.141) neni 6 paragrafët 1 dhe 2, sipas kushteve të referuara aty, kur vepra e treguar konsiston në një nga veprat penale të vendosura, në përputhje me nenet 2 deri 12 të kësaj konvente, në rastin kur Pala nuk ka bërë rezervime apo deklarime, lidhur me këto vepra ose nuk i konsideron këto vepra si serioze për qëllimin e legjislacionit të saj për pastrimin e parave.”

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit është ratifikuar me ligjin nr. 9492, datë 13. 3. 2006. Qëllimet e kësaj konvente janë: a) nxitja dhe forcimi i masave për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit më me efikasitet dhe efektivitet; b) nxitja, lehtësimi dhe mbështetja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe asistencës teknike në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë rimarrjen e pasurisë; c) nxitja e integritetit, përgjegjësisë dhe administrimi i rregullt i çështjeve publike dhe pasurisë publike. Për përmbushjen e këtyre qëllimeve, konventa parashikon detyrime për shtetet anëtare në fushën e masave që duhet të marrin për parandalimin e pastrimit të parave.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, i ndryshuar, në nenin 287 të tij parashikon veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale”, si një krim, me tre paragrafë që shkojnë në rëndim të masës së dënimit penal, varësisht shkëljes penale përkatëse.

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29. 12. 2008, i ndryshuar, përcakton ndër të tjera edhe burimet e financimit të fushatës për subjektet zgjedhore, të tilla si: a) fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore; b) të ardhurat e vetë subjektit zgjedhor të krijuara sipas ligjit; c) dhuratat për subjektin zgjedhor dhe kandidatët e tij, në vlerë monetare, natyrë ose shërbime të dhëna, sipas ligjit; ç) huat ose kreditë e marra nga partitë politike ose kandidatët e tyre sipas ligjit.

Ligji nr. 9917, datë 19. 5. 2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, mund të konsiderohet ligji i posaçëm në këtë fushë, në të cilin parashikohen subjektet që i nënshtrohen këtij ligji, vigjilenca e duhur nga ana e tyre, vigjilenca e zgjeruar ndaj klientit, masat parandaluese që duhet të ndërmerren nga subjektet, detyrimet për raportim, strukturat përgjegjëse dhe mbikqyrëse të zbatimit të këtij ligji. Në nenin 23 të këtij ligji parashikohet krijimi i Komitetit të Bashkëpunimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave si

institucion përgjegjës për përcaktimin e drejtimeve të politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Nga studimi i këtij ligji rezulton se janë marrë modelet më të mira⁸ në fushë, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për zbatimin e tij. P.sh. për miratimin dhe zbatimin e një analize risku të përditësuar me veprimtaritë në të cilat ka tendencë të lartë pastrimi parash. Do ishte e nevojshme më shumë transparencë dhe informim të publikut për gjetjet dhe rastet e goditura në këtë fushë. Ky informacion shpesh mbahet konfidencial.

Ligji nr. 72/2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”- Qëllimi i këtij ligji është vendosja dhe zbatimi i masave shtrënguese ndërkombëtare në funksion të ruajtjes së paqes dhe sigurisë, parandalimit të konflikteve ndërkombëtare, mbështetjes dhe forcimit të demokracisë, sundimit të ligjit të drejtave të njeriut, si dhe arritjes së objektivave të tjerë të sigurisë së përbashkët, në përputhje me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

Ligji nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit, i ndryshuar”- Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja e veprimtarive të terroristëve dhe e atyre që mbështesin dhe financojnë terrorizmin, apo të atyre, për të cilët ka dyshime të bazuara që kanë kryer, po kryejnë ose kanë qëllim të kryejnë veprimtari të tilla, nëpërmjet bllokimit, sekuestrimit të fondeve e pasurive të tyre, në zbatim të rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Ligji nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”- Qëllimi i këtij ligji është miradministrimi dhe përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nga organet e drejtësisë dhe pasurive të sekuestruara me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, rikthimi në komunitet i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimi financiar i viktimave të kimit.

Ligji nr. 8580, datë 17. 2. 2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, parashikon ndër të tjera në një kre më vete, mjetet financiare dhe materiale të partive politike. Aty përcaktohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive politike. Burimet e financimit të partive politike dhe transparenca e tyre rrjedhin jo vetëm si një detyrim kushtetues, por edhe si një garanci që të shmangen financimet e paligjshme, të cilat më pas ndikojnë në jetën politike dhe shtetërore në vend.

⁸ Agjencia e Inteligjencës Financiare. Bashkëpunimi Nderkombetar. Marrë nga <https://fiu.gov.al/sq/bashkepunimi-nderkombetar/>.

Pavarësisht konstatimeve të publikut, të medias apo të organizatave monitoruese të proceseve zgjedhore për financime të dyshimta apo të paligjshme nuk rezulton që KQZ⁹ të ketë referuar çështje të posaçme të pastrimit të parave nga partitë politike. Pra edhe në këtë aspekt ndoshta duhet KQZ të pajiset me një metodologji të caktuar që jo thjesht për të verifikuar rregullshmërinë formale të financimit, por për të zbuluar nëse fonde të paligjshme dhe rrugë të pastrimit të parave janë përdorur nga partitë politike e sidomos gjatë fushatave zgjedhore.

Ligji nr.9049, datë 10. 4. 2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që ka për qëllim kryesor përcaktimin e rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjiti mitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta.

Ligji nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të cilit i është zgjatur afati i veprimit deri me datën 31.12.2023 ka për qëllim kryesor nxitjen dhe tërheqjen e investimeve strategjike, vendase dhe të huaja, në sektorët e ekonomisë, të identifikuar si sektorë strategjikë, nëpërmjet vendosjes së procedurave të posaçme administrative favorizuese, lehtësuese apo përsheptuese të mbështetjes e të shërbimeve ndaj investitorëve. Një nga kërkesat kryesore është që investitori të ketë fonde të mjaftueshme për të realizuar investimin e synuar. Institucion i ngarkuar me ligj për të administruar praktikat përkatëse është Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA). Ndër të tjera, kjo agjenci analizon paraprakisht profilin e investitorit dhe për këtë qëllim ka të drejtë t'i kërkojë investitorit informacione lidhur me kapacitetin financiar dhe aftësinë e tij për të gjeneruar fonde të mjaftueshme për financimin e investimit, deklaratat financiare, strukturën menaxheriale, pronësinë, pozicionimin në treg, eksperiencat e mëparshme, lidhur me fushën e investimit, projekte të ngjashme, si dhe komponentë të tjerë të nevojshëm për të provuar aftësitë e tij investuese dhe potencialin për të qenë investitor strategjik për projektet e investimeve strategjike. Meqenëse pjesa më e madhe e investitorëve strategjikë kanë investuar në ngritjen e strukturave turistike bregdetare nuk rezulton sesi kjo agjenci¹⁰ e ka kryer verifikimin e prejardhjes së fondeve të këtyre investimeve. Nëse një pjesë kryesore e fondeve vijnë në rrugë bankare, prezumohet se verifikimi i ligjshmërisë së këtyre fondeve është kryer nga sistemi bankar, por nëse një pjesë e investimit është kryer bazuar në kontratat e kleringut apo të shkëmbimit, ose të shitjes paraprake të njësisë, këtu nuk del e qartë se cili subjekt e ka kryer verifikimin e prejardhjes së fondeve, pavarësisht se në teori prezumohet se për çdo marrëdhënie juridike është lidhur një akt noterial dhe si i tillë transaksioni apo fondet e transferuara verifikohen nga noteri. Por ka plot raste në praktikë që vetë investitori strategjik e përpilon kontratën me palën e tretë, me shkresë të thjeshtë dhe objekti i shkëmbimit ose parapagimi për njësinë e pandërtuar ende, mbetet i paverifikuar.

⁹ Faqe zyrtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve <https://kqz.gov.al/monitoruesit-audituesit/>.

¹⁰ Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA). Raport Vjetor. Marrë nga <https://www.aida.gov.al/sq/aida/raport-vjetor>.

2.3 Intervista të thelluara

Institucionet/organizatat e mëposhtme, janë kontaktuar për t'u intervistuar në lidhje me financimet e paligjshme në Shqipëri:

Kuvendi

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave

Banka e Shqipërisë

Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare

Dhoma Kombëtare e Noterëve

Dhoma Kombëtare e Avokatëve

Shoqata Shqiptare e Bankave

ILDKPI

Nga intervistat e zhvilluara me përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave të kontaktuar rezulton se të gjitha këndvështrimet e ndryshme ndaj çështjes së financimeve të paligjshme në Shqipëri pajtohen dhe konvergojnë në faktin që legjislacioni aktual është i miratuar së fundmi dhe adreson si duhet trajtimin e financimeve të paligjshme, duke qenë në përputhje me qasjen e BE në këtë fushë si dhe kontekstin shqiptar. Si rrjedhojë, zbatimi i legjislacionit mbi financimet e paligjshme deri më sot nuk ka hasur probleme thelbësore nga ana e institucioneve përgjegjëse dhe subjekteve të ligjit, ndonëse ka hapësira për përmirësime të mëtejshme.

Këto lidhen kryesisht nga njëra anë me specifikat e kontekstit lokal të Shqipërisë si dhe nga ana tjetër me dinamikën e shpejtë të zhvillimit të tregut financiar që kërkon mbështetjen e teknologjive dhe zgjidhjeve të reja online, për të cilat gjithashtu nevojitet një sistem gjithnjë e më efikas e i sofistikuar për parandalimin e financimeve të paligjshme, i cili njëkohësisht mundëson zhvillimin e sektorit financiar përmes përdorimit të teknologjive dhe zgjidhjeve të reja.

Nga ky këndvështrim përshembull, legjislacioni shqiptar mund të plotësohet edhe më tej për të mundësuar pa pengesa të panevojshme prirjen drejt teknologjive të reja dhe kërkesës për identifikimin dhe verifikimin (prania fizike) të klientëve të institucioneve financiare, gjë që aktualisht përcaktohet shkurtimisht në ligj. Po kështu mund të përmenden praktika që ende vijojnë të përdoren në Shqipëri ndonëse nuk zbatohen si të tilla në vendet e Bashkimit Europian, dhe që bien ndesh me legjislacionin mbi të dhënat personale, sic është përshembull përdorimi i atësisë së klientit për identifikimin dhe verifikimin e tij.

Duke qenë se në tregun financiar shqiptar operojnë si subjekte vendase ashtu dhe degë lokale të operatorëve ndërkombëtarë e kryesisht të atyre nga vendet e Bashkimit Europian, praktika e punës dëshmon që degët e kompanive ndërkombëtare janë shpesh një hap para në zbatimin e legjislacionit mbi financimet e paligjshme, kjo si rrjedhojë e rregullave dhe kërkesave të grupit apo kompanisë mëmë me qendër në BE ku ato bëjnë pjesë. Për rrjedhojë, ndodh që operatorët gjenden edhe në pozita jo të barabarta në treg ndaj dhe unifikimi i praktikave dhe standarteve si dhe minimizimi i hapësirave potenciale për financimet e paligjshme, mbetet jo vetëm nevojë e përcaktimeve ligjore por dhe detyrë e institucioneve zbatuese si dhe veçanërisht e organizimeve të operatorëve në treg (shoqatave).

Këto të fundit kanë një rol të pazëvendësueshëm dhe tepër të rëndësishëm për kryerjen, krahas të tjerave, të aktiviteteve si trajnimet e vazhdueshme të stafeve të operatorëve mbi problematikën e financimeve të paligjshme, krijimi i ekipeve trajnuese, fushatat ndërgjegjëse

me klientët dhe publikun, bashkëpunimi dhe ndarja e përvojave me institucione homologe në rajon dhe vendet e BE etj.

2.4 Analizë e praktikave të mira

Financimet e paligjshme, që përfshijnë financimin e veprimtarive terroriste, evazionin fiskal, pastrimin e të ardhurave nga korrupsioni ose të përfituara në mënyrë kriminale, pranohet se paraqesin një nga kërcënimet më të mëdha për një të ardhme të qëndrueshme. Financimet e paligjshme financiare përkeqësojnë më tej sfidat më të rëndësishme sociale, politike dhe mjedisore në botë duke kontribuar në përdorimin e paligjshëm të burimeve kombëtare, duke krijuar infrastrukturë pa standarde, mungesë financimesh për programe sociale dhe mund të pengojnë investimet e duhura aty ku ato nevojiten më shumë.

Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) si një organ i pavarur ndërqeveritar, që zhvillon dhe promovon politika për të mbrojtur sistemin financiar global kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë ofron rregullisht rekomandime që njihen si standardi global kundër pastrimit të parave (AML) dhe kundër financimit të terrorizmit (CFT).

Zbatimi i rekomandimeve të FATF në Shqipëri vlerësohet nga MONEYVAL - Komisioni i Ekspertëve për Vlerësimin e Kundër Pastrimit të Parave, Masat dhe Financimi i Terrorizmit. MONEYVAL është organ i përhershëm monitorues i Këshillit të Evropës që kryen vlerësimin e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe efektivitetin e zbatimit të tyre. Ai gjithashtu jep rekomandime për autoritetet kombëtare në lidhje me përmirësimet e mekanizmave kombëtarë.

FATF¹¹ identifikon rregullisht juridiksionet me masa të dobëta për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në dy dokumente publike që publikohen tre herë në vit. Procesi i FATF për të listuar publikisht vendet me regjime të dobëta ka rezultuar efektiv. Që nga qershori 2023, FATF ka shqyrtuar mbi 125 vende dhe juridiksione dhe ka identifikuar publikisht 98 prej tyre.

Gjatë periudhës Shkurt 2020 – Tetor 2023, Shqipëria ka qenë vlerësuar si pjesë e listës gri, e cila përfshin vendet që po punojnë në mënyrë aktive me FATF-në për të adresuar mangësitë strategjike në regjimet e tyre për të luftuar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe përhapjen e financimit. Kur FATF vendos një juridiksion nën monitorim të rritur, kjo do të thotë se vendi është angazhuar të zgjidhë me shpejtësi mangësitë strategjike të identifikuara brenda afateve kohore të dakorduara dhe i nënshtrohet një monitorimi të rritur. Në Shkurt 2023, FATF deklaroi se Shqipëria kishte përfunduar në mënyrë thelbësore planin e saj të veprimit dhe shprehu vlerësimin për përpjekjet për të adresuar mangësitë e saj strategjike. Së fundmi, më 27 Tetor 2023, FATF vendosi të heqë Shqipërinë nga lista e saj gri¹².

Ndonëse FATF identifikon rregullisht juridiksionet që përfshihen në listën e zezë dhe atë gri, si dhe jep rekomandime të detajuara për të adresuar problematikën që lidhet me financimet e paligjshme, duke u bazuar edhe në praktikat më të mira, nga këto raporte nuk mund të

¹¹ Task Forca e Veprimit Financiar. Marrë nga <https://www.fatf-gafi.org/en/the-fatf/who-we-are.html>.

¹² Task Forca e Veprimit Financiar. Marrë nga <https://www.fatf-gafi.org/en/publications/High-risk-and-other-monitored-jurisdictions/Increased-monitoring-october-2023.html>.

vlerësohet se cilat janë vendet që i kanë të adoptuara praktikat më të mira. Për këtë qëllim vlen të analizohen raporte të tjera, si indeksi i AML-së së Bazelit¹³, publikuar nga Instituti i Bazelit për Qeverisjen¹⁴, i cili mat vlerat e rrezikut të vendeve në kuadër të metodologjisë së përcaktuar nga ky institucion bazuar në cilësinë e kornizës ligjore, riskut të korrupsionit, transparencës financiare dhe standarteve, transparencës ndaj publikut dhe llogrithënies si dhe riskut politik dhe ligjor në çdo vend. Në këtë raport, për vitin 2023 Shqipëria renditet në vendin e 93-të nga 152 vende pjesëmarrëse¹⁵, ndërkohë që rezultatet më mira i kanë vendet nordike (Islanda 152, Finlanda 151, Suedia 148) dhe vende të tjera si Zelanda e Re, Franca, Danimarka, Izraeli, UK, Australia etj.

Realiteti dëshmon se edhe në vendet më të përparuara në luftën ndaj financimeve të paligjshme, problematika ekziston. Kështu përsëritet ndërsa Suedia konsiderohet tradicionalisht si një destinacion i sigurt financiar (renditet si vendi i tretë në indeksin e AML-së së Bazelit), skandalet e fundit kriminale e kanë dëmtuar këtë reputacion. Në vitin 2019, një hetim në bankën suedeze Sëedbank ekspozoi një skemë 200 milionë dollarësh të pastrimit të parave në degët e saj të Evropës Lindore dhe Ruisë që solli një gjobë prej 360 milionë euro. Në mënyrë të ngjashme, në vitin 2022, hetuesit zbuluan shkelje rregullatore të pastrimit të parave në kompanitë suedeze të lojërave të fatit Kindred, ATG dhe Pinbet – dhe më pas dhanë miliona euro gjoba për secilën kompani.

Një nga mënyrat më efektive për të forcuar përputhshmërinë me kërkesat e shqyrtimit të bazuar në risk është kontrolli i klientëve për përfshirje në media apo lajme negative. Raportet e lajmeve dhe format e tjera të mediave online shpesh zbulojnë informacione për klientët përpara se të konfirmohet zyrtarisht – duke u mundësuar firmave të reagojnë sa më shpejt që të jetë e mundur kur ndryshon profili i riskut të klientit. Rregullat e BE-së kërkojnë që firmat të zbatojnë kontrollin e medias si pjesë e procesit të verifikimit të pajtueshmërisë me financimet e paligjshme. Kjo kërkon që kompanitë duhet të integrojnë programe të aftë për të kontrolluar mediat e pafavorshme në një shkallë globale, me një mbulim që përfshin mediat tradicionale të shtypit dhe ekranit, faqet e internetit dhe burime të tjera të dhënash si blogjet, forumet dhe platformat e mediave sociale.

Prirjet më të fundit ndaj financimeve të paligjshme në vendet e Bashkimit Europian synojnë (i) unifikimin e një zyre të vetme për luftën ndaj pastrimit të parave, (ii) forcimin e rregullave për financimet e paligjshme në tregun e kriptomonedhave, dhe (iii) sofistikimin e teknologjisë së kërkimit dhe inteligjencës artificiale për informacionet që lidhen me financimet e paligjshme. Këto çështje duhet të jenë në vëmendje edhe të politikbërjes në Shqipëri, jo vetëm për të përafuar legjislacionin shqiptar me atë të BE, por dhe për të adresuar si duhet e në kohë problematikën e rëndësishme me të cilat sot përballen të gjitha vendet.

Krahas vlerësimit në nivel vendi, përpjekjet për të luftuar korrupsionin dhe financimet e paligjshme mund të kenë sukses vetëm me përfshirjen si duhet të sektorit privat në këtë proces. Në mënyrë të veçantë, aktiviteti me praktika të përgjegjshme në çdo aspekt të funksionimit, bashkëpunimi brenda sektorit dhe zinxhirët e furnizimit në degë si ai i sistemit bankar dhe financiar, kontabilistët, avokatët, agjentët e pasurive të paluajtshme, janë disa nga hallkat e sektorit privat me rol të jashtëzakonshëm për parandalimin dhe ndërprerjen e financimeve të paligjshme. Banka Botërore dhe Forumi Ekonomik Botëror sugjerojnë që këto aktivitete të

¹³ Indeksi i AML-së së Bazelit. Marrë nga <https://index.baselgovernance.org/>.

¹⁴ Instituti i Bazelit për Qeverisjen. Marrë nga <https://baselgovernance.org/>.

¹⁵ Indeksi i AML-së së Bazelit 2023. Marrë nga <https://baselgovernance.org/publications/basel-aml-index-2023>.

mbështeten në parimet e integritetit, transparencës dhe llogaridhënies, si dhe të ndjekin pesë praktika të nevojshme: politika të qarta, konkrete dhe të përditësuara; promovimi i rishikimit të kujdesshëm (due diligence); mbujtja e një kulturë integriteti përmes trajnimeve dhe stimuljeve; nxitja e kulturës së të folurit mbi problemet dhe denoncimit të rasteve; bashkëpunimi brenda dhe mes sektorëve të ndryshëm.

Financimet e paligjshme adresohen edhe në kuadër të funksionimit të organizatave jofitimprurëse. Një nga nëntë rekomandimet e FATF¹⁶ trajton pikërisht këtë çështje, duke theksuar se të gjitha vendet duhet të kryejnë një rishikim të përshtatshmërisë së rregulloreve dhe ligjeve që lidhen me organizatat jofitimprurëse të cilat vendi i ka identifikuar si të prekshme prej abuzimeve të mundshme lidhur me financimin e terrorizmit.

Përmbledhje e nëntë rekomandimeve të FATF:

I. Ratifikimi dhe zbatimi i instrumenteve të OKB-së

Çdo vend duhet të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të ratifikuar dhe zbatuar plotësisht Konventën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për Ndalimin e Financimit të Terrorizmit të vitit 1999.

II. Kriminalizimi i financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave që lidhen me to

Çdo vend duhet të kriminalizojë financimin e terrorizmit, akteve terroriste dhe organizatave terroriste. Vendet duhet të sigurojnë që shkelje të tilla të caktohen si shkelje të caktuara të pastrimit të parave.

III. Ngrirja dhe konfiskimi i pasurive terroriste

Çdo vend duhet të zbatojë masa për ngrirjen pa vonesë të fondeve apo pasurive të tjera të terroristëve, atyre që financojnë terrorizmin dhe organizatat terroriste në përputhje me rezolutat e Kombeve të Bashkuara lidhur me parandalimin dhe shtypjen e financimit të akteve terroriste.

IV. Raportimi i transaksioneve të dyshimta lidhur me terrorizmin

Nëse institucionet financiare, apo bizneset apo entitetet e tjera që i nënshtrohen detyrimeve kundër pastrimit të parave, dyshojnë ose kanë arsye të arsyeshme për të dyshuar se fondet janë të lidhura ose të lidhura me, ose do të përdoren për terrorizëm, akte terroriste ose nga organizata terroriste, atyre duhet t'u kërkohet të raportojnë menjëherë dyshimet e tyre tek autoritetet kompetente.

V. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Çdo vend duhet të përballojë një vend tjetër, në bazë të një traktati, marrëveshje apo mekanizmi tjetër për ndihmën e ndërsjellë ligjore ose shkëmbimin e informacionit, masën më të madhe të mundshme të ndihmës në lidhje me hetimet, hetimet dhe procedimet penale, civile dhe administrative lidhur me financimin e terrorizmit, akteve terroriste dhe organizatave terroriste.

VI. Remitancat alternative

Çdo vend duhet të marrë masa për të siguruar që personat ose entet ligjore, duke përfshirë agjentët, që ofrojnë një shërbim për transferimin e parave ose vlerës, duke përfshirë atë nëpërmjet një sistemi apo rrjeti jozyrtar të transferimit të parave ose vlerës, duhet të licensohen ose të regjistrohen dhe t'i nënshtrohen të gjitha Rekomandimeve të FATF-it që zbatohen për bankat dhe institucionet financiare jobankare. Çdo vend duhet të sigurojë që personat ose entet ligjore që kryejnë këtë shërbim në mënyrë të paligjshme t'i nënshtrohen sanksioneve administrative, civile ose penale.

VII. Transfertat bankare

¹⁶ Nëntë rekomandimet e FATF: <https://www.fatf-gafi.org/en/publications/Fatfrecommendations/lxspecialrecommendations.html>.

Vendet duhet të marrin masa për t'u kërkuar institucioneve financiare, duke përfshirë dërgesat e parave, që të përfshijnë informacion të saktë dhe kuptimplotë të nismëtarit (emri, adresa dhe numri i llogarisë) mbi transfertat e fondeve dhe mesazhet e lidhura me to që dërgohen dhe informacioni duhet të mbetet me transferimin ose mesazhin e lidhur me të nëpërmjet zinxhirit të pagesave.

VIII. Organizatat jofitimprurëse

Vendet duhet të rishikojnë përshtatshmërinë e ligjeve dhe rregullave që lidhen me njësitë që mund të abuzohen për financimin e terrorizmit. Organizatat jofitimprurëse janë veçanërisht të pambrojtura dhe vendet duhet të sigurohen se ato nuk mund të keqpërdoren:

- i) nga organizatat terroriste që paraqiten si entitete legjitime;
- ii) për të shfrytëzuar njësitë legjitime si kanale për financimin e terrorizmit, duke përfshirë edhe me qëllim shmangien e masave për ngrirjen e asetëve; dhe
- iii) për të fshehur ose maskuar devijimin fshehurazi të fondeve të destinuara për qëllime të ligjshme, drejt organizatave terroriste.

IX. Transferuesit e parave

Vendet duhet të kenë masa për të zbuluar transportin fizik ndërkufitar të monedhave dhe instrumenteve të negociueshme të bartësve, duke përfshirë një sistem deklarimi ose detyrim tjetër për zbulimin e tyre.

Vendet duhet të aplikojnë masa të fokusuara dhe proporcionale, në përputhje me qasjen e bazuar në risk, ndaj organizatave të tilla jofitimprurëse t'i mbrojnë ato nga abuzimi me financimin e terrorizmit, në mënyrë që të mos keqpërdoren nga organizatat terroriste që paraqiten si subjekte legjitime; për të shfrytëzuar entitete legjitime si kanale për financimin e terrorizmit, duke përfshirë qëllimin për t'i shpëtuar masave të ngrirjes së asetëve; dhe për të fshehur përdorimin e fondeve të destinuara për qëllime legjitime nga organizatat terroriste.

3. Financimet e paligjshme në Shqipëri

Në këtë seksion, i bëhet një analizë e detajuar **projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/ 2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë””, i ndryshuar**, për të vlerësuar hapësirat eventuale për korrupsion. Lista e kriterëve e cila do të përdoret për të realizuar një vlerësim të tillë, është e paraqitur si në figurën 1.

3.1 Konsiderata të Përgjithshme

Projekt-ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 155/ 2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i depozituar për shqyrtim në Kuvend në muajin Korrik të vitit 2023 nuk rezulton të ketë qenë i përfshirë në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, për këtë vit. Në këtë kuptim vjen si iniciativë e papritur dhe ndoshta e pa konsultuar gjerësisht me subjektet, të cilat e kanë vuajtur si plagë sociale, fenomenin e lojërave të fatit. Marrë në kompleksitet me ligjin pararendës nr.75/ 2018, me të cilin ndër të tjera u mbyllën të gjitha lojërat e fatit me përjashtim të atyre si “kazino”, “resort kazino” apo “lotari kombëtare” relacioni shoqëruar i këtij Projekt-ligji nuk rezulton të ketë unitet me të, si dhe lë pa përgjigje disa çështje të natyrshme të kësaj fushe.

- **Gjendja faktike e subjekteve që ofrojnë lojëra fati:** Siç rezulton nga legjislati i cili në fuqi lojërat e fatit kanë vijuar për subjektet e licencuar si “kazino”, “resort kazino”


apo "lotari kombëtare". Në relacionin shoqëruës nuk jepet asnjë e dhënë sesa subjekte të tilla veprojnë, si ka vijuar puna te ato, të ardhurat e tyre janë në rritje këto 5 vite që janë mbyllur lojërat e tjera të fatit, etj. Pra në relacion nuk ka asnjë shpjegim për gjendjen faktike, të këtyre subjekteve që e ushtrojnë këtë veprimtari konform ligjit dhe licencave përkatëse.

- **Aspekti social:** Në relacionin shoqëruës nuk jepet asnjë e dhënë për aspektin social, nëse ky projektligj është diskutuar me grupet vulnerabël, që vuajnë nga varësia e lojërave të fatit ose në ndonjë sondazh sesi pritet nga qytetarët rihapja e lojërave të fatit. Mos trajtimi i aspektit social i shton dilemat duke qenë se në vitin 2018 lojërat e fatit u mbyllën me arsyetimin për të ndaluar plagët sociale, që kishin shkaktuar në shoqërinë shqiptare, po ndërkohë nuk rezultoi që të lartpërmendurit të jenë trajtuar me mbështetje të posaçme për të shmangur varësinë e tyre nga lojërat e fatit apo familjet e tyre, që kishin humbur shtëpitë për shkak të borxheve të lojërave të fatit, etj.
- **Parandalimi i pastrimit të parave:** Projekt-ligji mjaftohet me parashikimin e ligjit ekzistues në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, ndërkohë që në relacionin shoqëruës nuk jepet asnjë e dhënë e raporteve të brendshme të drejtorisë përkatëse apo të organizmave të huaj, nëse ka patur pastrim parash në fushën e lojërave të fatit në Shqipëri. Ndërkohë që subjektet aplikuese për licencë të basteve sportive on-line i duhen nënshtruar një kontrolli të imët në aspektin e pastrimit të parave, pasi në kriteret për licencim parashikohen shuma të konsiderueshme kapitali fillestar, që duhen verifikuar në çastin e aplikimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.
- **Mungesa e konkurrencës për subjektet aplikuese:** Kriteret e parashikuara për subjektet aplikuese për licencë të basteve sportive on-line duken mjaft të ngurta dhe jo të lehta për t'u plotësuar. P.sh. duhet që subjekti aplikues apo njëri prej aksionerëve të tij të ketë përvojë në fushën e lojërave të fatit në jo më pak se 3 shtete të BE/OECD dhe jo për më pak se 3 vjet. Shtrohet pyetja një subjekt aplikues që ka eksperiencë të tillë vetëm në Francë, pse nuk mundet të aplikojë? Çfarë i shton atij nëse ka eksperiencë edhe në Bullgari dhe në Rumani, në të njëjtën kohë? Pra këto parashikime ligjore e bëjnë projektligjin të mbushet me kritere subjektive, që më shumë duken penguese/ kufizuese për hyrjen e shumë konkurrentëve dhe duket sikur është gjetur një subjekt, që ka veprimtari në 3 shtete si më lart, mbi 3 vite eksperiencë, etj. Një parashikim tjetër të kompetencat e Komisionit të Licencave, që ka detyrë të përcaktojë mënyrën, kushtet dhe dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e thirrjes për licencimin e subjekteve të cilat organizojnë lojërat e fatit, bën të lindë pyetja: kur dhe si e shpall thirrjen Komisioni? Po sikur ta shpallë një herë thirrjen sapo hyn ligji në fuqi dhe licencon një subjekt e më pas nuk shpall më një thirrje tjetër? Ja pse edhe ky parashikim i marrë në kompleksitet me të gjitha dispozitat e tjera krijon premisa për mungesë konkurrence në treg, si dhe për paracaktimin e një subjekti, që pret të licencohet.
- **Rreziku për fiksimin e rezultateve sportive dhe të mashtrimit me lojërat e fatit:** Në projektligj në nenin 9, pika 2/6 të tij parashikohet ndër të tjera që subjektet e licencuara për lojëra fati lejohen të sponsorizojnë skuadra sportive, si dhe të bëjnë publicitet të aktiviteteve të tyre. Një parashikim i tillë shton mundësinë për trukim të ndeshjeve, por dhe për organizimin e basteve mashtruese, ku qindra e mijëra lojëtarë mund të humbin para, për shkak të skemës së mësipërme.

3.2 Analiza e Hapësirave Eventuale për Korrupsion

Ky projektligj i duhet nënshtruar analizës së hapësirave eventuale për korrupsion për të nxjerrë se cilat pjesë apo dispozita të tij duhen përmirësuar, në mënyrë që fenomeni i korrupsionit, përfshirë edhe pastrimi i parave të mos ndodhin, pas hyrjes së tij në fuqi dhe zbatimit nga subjektet e përfshira. Në analizë i jemi referuar kategorive kryesore për të nxjerrë hapësirat korruptive, ndërsa në pjesën e footnotes kemi renditur nënçështjet, të cilat mund t'i përdorim rast pas rasti, si ndihmë për të nxjerrë edhe hapësirat indirekte për korrupsion.

Figura 1¹⁷: Kategoritë e kritereve për vlerësim të hapësirave korruptive



A. Dykuptueshmëria - Dykuptueshmëria si kriter i vlerësimit të hapësirave për korrupsion ka të bëjë atëherë, kur një normë juridike, fjali apo shprehje ka më shumë se një kuptim, duke krijuar

¹⁷ Listë kontrolli e hapësirave korruptive- përpiluar nga bashkëautorët e këtij studimi.

kësisoj konfuzion te zbatuesi i së drejtës dhe duke lënë hapësira subjektive në zbatimin e vetë ligjit.

A.1 Stili gjuhësor¹⁸ – Gjuha e projektligjit duhet të jetë e thjeshtë, me fjali të ndërtuara saktë nga pikëpamja gramatikore dhe leksikore.

- Në përgjithësi projekt-ligji që po analizojmë ka një gjuhë të kuptueshme e në unitet me ligjin bazë që ai ndryshon, por konstatohen edhe formulime që krijojnë dykuptimësi ose që janë të paqarta, si p.sh: neni 17/1, pika 5, shkronja “a”, ku parashikohet se: “Komisioni i Licencave ka këto detyra: a) Përcakton mënyrën, kushtet dhe dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e thirrjes për licencimin e subjekteve të cilat organizojnë lojërat e fatit;” Nga formulimi duket sikur mund të aplikohet për licencë vetëm pas thirrjes së bërë nga Komisioni, gjë që nuk është konform me pjesën tjetër të legjislacionit në fuqi. Po nëse Komisioni nuk bën një thirrje të tillë a munden të aplikojnë subjektet? Pra kjo dispozitë duhet të riformulohet, duke shmangur dykuptimësinë.

A2. Harmonizimi¹⁹- Projekt-ligji duhet të përmbajë norma juridike, që kanë unitet me njëra-tjetrën, rrjedhshmëri, lidhje llogjike dhe që nuk krijojnë kontradikta brenda projektligjit vetë apo që nuk krijojnë kontradikta, ose më tej të bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

B. Rreziqet Substanciale

B.1 Objektivat e ligjit²⁰ – Objektivat e projektligjit parashikohen në dispozitat e përgjithshme të tij, të titulluara, si: “objekti”, “qëllimi”, ndërkohë një përshkrim më i detajuar i objektive jepet në relacionin shoqërues të projektligjit, i cili duhet të përshkruajë problemin, që synon të zgjidhë projekt-ligji i ri, një vlerësim të gjendjes faktike dhe të argumentojë, që pse një projektligj i ri është zgjidhja e duhur për atë çështje të krijuar.

-Objektivat e projekt-ligjit që janë të renditura në relacionin shoqërues në këtë rast janë më shumë të karakterit pragmatist, pra meqenëse lojërat ilegale të fatit po lulëzojnë, atëherë le t’iu japim një mundësi lojtarëve, të paktën, të luajnë on-line që dhe shteti të arkëtojë të të ardhura nga kjo veprimtari. Relacioni nuk është i plotë në përshkrimin e lojërave të fatit të licencuara sesi po performojnë ato, nëse ka nevojë tregu për subjekte të tjera, etj. Relacioni nuk është i plotë as në aspektin e kostove të rënda sociale që shkakton intensifikimi i lojërave të fatit në vend.

B.2 Procedurat²¹- Procedura është e parashikuar në projektligj. I është lënë një diskrecion i gjerë ministrit përgjegjës për financat për të përcaktuar me udhëzim kriteret e vlerësimit, afatet,

¹⁸ A.1.1 Fjalët e përzgjedhura a janë të sakta? A.1.2 A janë ndërtuar fjalitë dhe frazat saktë duke mos lënë hapësirë për dykuptimësi?

¹⁹ A.2.1. A ka dispozita kontradiktore brenda ligjit? A ka dispozita kontradiktore me ligjet e tjera? A.2.2 A është terminologjia e përdorur e saktë dhe konsistente? A.2.3 A janë referencat e sakta dhe të qarta brenda ligjit? A janë referencat e sakta dhe të qarta tek ligjet e tjera? A.2.4 A i mbulon teksti i ligjit të gjitha çështjet? A ekziston ndonjë vakuum ligjor?

²⁰ B.1.1 A është kryer vlerësimi paraprak dhe a është i saktë? A janë përcaktuar objektivat e ligjit në përputhje me vlerësimin paraprak? B.1.2 Rregullat e hartuara të ligjit a janë koherente me objektivat e ligjit?

²¹ B.2.1 A është përcaktuar diskrecioni në masën e duhur, që të mos jetë i gjerë? A ka kriteret që përcaktojnë diskrecionin? A ka diskrecion për të zbatuar përjashtimin nga rregulli? B.2.2 A ka diskrecion rregullator? B.2.4 A është e qartë procedura e përcaktuar? B.2.5 A është e thjeshtë procedura, pa pengesa të tejskajshme? B.2.6 A sigurohet akses i duhur në informacion gjatë procedurës? B.2.7 A janë caktuar afate për hapat proceduralë? A janë të sakta dhe të përshtatshme afatet? B.2.8 A garanton konkurrencën e lirë procedura, nëse vendos rregulla përzgjedhëse? B.2.9 A është e qartë procedura e vendimmarrjes? A janë kriteret e qarta për vendimmarrje?

procedurën e konkurrimit dhe pikëzimin, ndërkohë që mund të parashikoheshin në projektligj disa parime për vlerësimin dhe pikëzimin e subjekteve aplikuese. Duke qenë se as në relacionin shoqëruar apo në akte të tjera nuk jepet se cili model është marrë për të parashikuar një procedurë të testuar, në një shtet të konsoliduar dhe me eksperiencë në fushën e lojërave të fatit duket se procedura është e krijuar në përshtatje me kushtet në vendin tonë.

B.3 Organi zbatues²²

- Në projektligj janë caktuar organet zbatuese, si dhe ato kontrolluese, që shqyrtojnë ankimet administrative.

B.4 Mbikëqyrja²³

- Projekt-ligji parashikon një mekanizëm mbikëqyrës, që mund të ushtrohet nga organi epror që është ministri përgjegjës për financat.

B.5 Sanksionet²⁴

- Në projektligj parashikohet sanksione, që marrë bashkë me sanksionet në ligjin ekzistues janë të mjaftueshme për ata që kryejnë shkelje ligjore në këtë fushë.

B.6 Kontrolli gjyqësor²⁵

Subjektet e përfshira në fushën që rregullohet nga ky projektligj e kanë mundësinë që t'i drejtohen autoriteteve gjyqësore në rast cënimi të të drejtave të tyre.

3.3 Disa komente specifike në lidhje me përmbajtjen e draft-ligjit

- Projekt-ligji i propozuar pranon hapur dështimin e mbylljes së basteve on-line në vitin 2018 por në relacion mungon një analizë përmbledhëse e faktorëve që sollën këtë dështim, të cilët mund të jenë po aq ndikues edhe në dështimin apo mosfunksionimin si pritjet në të ardhmen të skemës së propozuar, e po ashtu mungon edhe një analizë financiare e efekteve të këtij dështimi.
- Neni 2, pika 6, përkufizimi i termit bast on-line ka nevojë për përcaktim më të plotë. Problemi lidhet me faktin që terminologjia e përdorur “vendosur në faqe Interneti ose platformë elektronike të dedikuar, të autorizuar dhe të monitorueshme” është e paplotë pasi nuk përcakton si duhet faktin që pjesëmarrja e lojtarëve dhe monitorimi i procesit bëhet në kohë reale dhe të pamanipulueshme.

²² B.3.1 A është caktuar një organ kompetent për zbatimin e ligjit apo të aktit nënligjor? B.3.2 A janë caktuar qartë kompetencat e organit? A ka mbivendosje kompetencash? B.3.3 Nëse organi zbatues është deleguar të rregullohet me akt nënligjor, a është caktuar një afat për nxjerrjen e organit nënligjor? A ka rrezik për ngritjen e vonuar të organit? B.3.4 A është parashikuar më shumë se një organ për zbatimin e ligjit? A janë koherente kompetencat e tyre? A është e qartë se cili është organi kryesor përgjegjës? B.3.5 A respektojnë rregullat e hartuara standardet e parandalimit dhe të shmangies së konfliktit të interesave?

²³ B.4.1 A parashikon ligji një mekanizëm mbikëqyrës? B.4.2 A garanton ligji transparencë të zbatimit të tij?

²⁴ B.5.1 A përcakton ligji sanksione në rast të shkeljes së detyrimeve? B.5.2 A janë sanksionet proporcionale?

²⁵ B.6.1 A parashikon ligji kontrollin gjyqësor të veprimtarisë administrative? B.6.2 Rregullat për kontrollin gjyqësor a janë formuluar qartë?

- Projekt-ligji i propozuar përmban ndërhyrje që duket se nuk kanë lidhje me objektin e ndryshimeve në të. Ndonëse Projekt-ligji synon formalizimin e basteve online, në të propozohet ndryshimi në pikën 20 të Nenit 2, i cili nuk ka lidhje me bastet sportive online. (“20/1. “Lojë fati promocionale – jackpot” është loja që organizohet nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e lojërave të fatit, “kazino”, “resort kazino”, “kazino të vendosura në hotele me pesë yje”, që promovon besnikërinë e klientit, vetëm brenda ambienteve të autorizuara ku kryejnë veprimtarinë, sipas parashikimeve të licencës së tyre, sipas autorizimit përkatës të dhënë nga Komisioni i Licencave.”.). Theksojmë se në konsultimin publik institucionet kanë refuzuar të marrin parasysh propozime nga pale të tjera, pikërisht me argumentin se ato nuk lidhen me objektin e ndryshimeve në ligj.
- Ndërkohë që Projekt-ligji përmban ndërhyrje të shumta në Nenin 9, lidhur me publicitetin, në relacion mungon një pasqyrë transparente e nevojës së këtyre ndërhyrjeve dhe pasojave në treg.
- Propozimet për ndryshim në Nenin 20, pika 3 përmbajnë termin ‘por pa u kufizuar vetëm në to’, i cili praktikisht e lë krejt të hapur teknologjinë që mund të përdoret dhe të panevojshme citimin e pajisjeve të tjera në të.
- Ndryshimet në pikën 5 të Nenit 20 përcaktojnë se standardet minimale miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat. Duke qenë se i gjithë aktiviteti është online dhe “konkuron” në tregun e Internetit me platforma të ngjashme në vende të tjera, sugjerojmë që këto standarte minimale të jenë gjithashtu në përputhje me ato të përdorura në vende të Bashkimit Europian.
- Neni 14, ndryshimet në Nenin 26, pika 3f, nuk është aspak e qartë se përse projekt-ligji zgjeron mundësinë e mbajtjes së llogarisë bankare për fondet e lojtarëve nga bankat e nivelit të dytë (ligji ekzistues) në institucione financiare (dmth edhe jo banka, sic propozohet).
- Neni 17, ndërhyrjet në Nenin 29, për Lotarinë Kombëtare sërish nuk lidhen as me përkufizimin e problemit (bastet online) dhe as me objektivat e projekt-ligjit të propozuar, ndërkohë që në konsultimin publik institucionet kanë refuzuar të marrin parasysh propozime nga pale të tjera, pikërisht me argumentin se ato nuk lidhen me objektin e ndryshimeve në ligj.
- Neni 24 shfuqizon pikën 2 të Nenit 46 në ligjin ekzistues (Organizatorët, që ushtrojnë aktivitetin e lojërave të fatit të basteve sportive, do të përdorin vetëm programe (softëare), të ndërtruara nga subjekte të autorizuara nga AMLF-ja për këtë qëllim, sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Financave. Programimi i lojërave të fatit “Baste sportive” në Republikën e Shqipërisë lejohet vetëm për personat juridikë të pajisur me autorizim të AMLF-së.). Nuk është e qartë përse është hequr kjo kërkesë dhe ku do kërkohet përgjegjësia në rastet e mosfunksionimit apo manipulimit të mundshëm.
- Përbërja e Këshillit të Mbështetjes së Projekteve, propozuar në Nenin 52/2 mund t’i lihet Këshillit të Ministrave, në përputhje me hierarkinë institucionale të institucioneve dhe AMLF.


3.4 Analizë e **ligjit nr. 66/ 2023 “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”**, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me datën 20. 07. 2023;

Konsiderata të përgjithshme

- Edhe në objektin e ligjit, por edhe në relacionin shpjegues të tij thuhet se në të përcaktohen rregullat për ndërtimet pa leje të konfiskuara, në përputhje me parashikimet e ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Por nëse është kështu, atëherë këto dispozita ligjore duhej të ishin një shtesë në vetë ligjin nr. 107/ 2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe jo ligj më vete.
- Ky ligj i ri në dukje për të trajtuar ndërtimet pa leje të konfiskuara, si të tilla nuk i jep zgjidhje disa çështjeve: (i) mbi çfarë kriteresh përcaktohet se nëse një ndërtim pa leje apo shtesë në volum apo sipërfaqe duhet të prishet apo të konfiskohet? (ii) jo gjithmonë prishja e një shtese pa leje ka lidhje me qëndrueshmërinë e ndërtesës in se, shpeshherë ka lidhje me të drejtën e qytetarëve për të patur më pak volum betoni në qytet? (iii) si ka mundësi që qenkan lejuar aq shumë ndërtime pa leje apo shtesa të tilla sa paska nevojë për një ligj të posaçëm për t’i dhënë zgjidhje se çfarë do të bëhet me ndërtimet e konfiskuara?
- Në thelb po të lexohet me kujdes konstatohet se ky ligj është një ligj i ri për legalizimin e ndërtimeve pa leje, të konceptuara si shtesa në volum apo sipërfaqe, të një godine të re të ndërtuar me leje ndërtimi, duke iu dhënë mundësi shoqërive ndërtuese të riblejnjë nga Shteti atë ndërtim pa leje, që ata kanë ngritur vetë.
- Pra nëse ligji Nr. 9482, datë 03. 04. 2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin ndërtimeve pa leje” i ndryshuar trajton ndërtimet pa leje të bëra si të tilla deri me datën 27. 6. 2014 dhe prezumohet që ndërtimet e tjera pa leje do të prisheshin, atëherë ky ligj i ri legalizon ndërtimet dhe shtesat pa leje, që kanë shpëtuar pa u prishur apo që janë ndërtuar në 10 –vjeçarin e fundit apo që do të ndërtohen në vijim.

Më poshtë do analizohen hapësirat eventuale për korrupsion, si dhe në aspektin e financimeve të paligjshme të këtij ligji:

Figura 2: Kategoritë e kritereve për vlerësim të hapësirave korruptive.



A. Dykuptueshmëria - Dykuptueshmëria si kriter i vlerësimit të hapësirave për korrupsion ka të bëjë atëherë, kur një normë juridike, fjali apo shprehje ka më shumë se një kuptim, duke krijuar kështu konfuzion tek zbatuesi i së drejtës dhe duke lënë hapësira subjektive në zbatimin e vetë ligjit.

A.1 Stili gjuhësor²⁶ – Gjuha e ligjit duhet të jetë e thjeshtë, me fjali të ndërtuara saktë nga pikpamja gramatikore dhe leksikore.

- Në dukje ligji ka një gjuhë të thjeshtë, si dhe synon të mbajë të njëjtën terminologji me legjislacionin ekzistues në fushën e ndërtimit, por që në nenin 1, parashikimi që përcakton rregulla për objektet e konfiskuara si ndërtime pa leje krijon një dyshim me legjislacionin ekzistues që nuk lë më ekuivok, pra ndërtimet pa leje prishen, si të tilla dhe nuk kuptohet se cilat janë këto shtesa apo ndërtime pa leje, që nuk do të prishen nga inspektorati i ndërtimit. Kjo çështje është e patrajtuar në legjislacionin ekzistues dhe në këtë ligj të ri, duke lënë hapësirë për diskrecion të gjerë, subjektivizëm dhe korrupsion.

²⁶ A.1.1 Fjalët e përzgjedhura a janë të sakta? A.1.2 A janë ndërtuar fjalitë dhe frazat saktë duke mos lënë hapësirë për dykuptimësi?

A2. Harmonizimi²⁷ - Ligji duhet të përmbajë norma juridike, që kanë unitet me njëra-tjetrën, rrjedhshmëri, lidhje llogjike dhe që nuk krijojnë kontradikta brenda ligjit vetë apo që nuk krijojnë kontradikta, ose më tej të bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

- Thelbi i ligjit krijon kontradiktë me legjislacionin në fuqi në fushën e ndërtimeve, ku legjislatori ka qenë i prerë, që nuk do të tolerohen më ndërtimet pa leje, shtesat në sipërfaqe apo volum. Pra ky ligj hap edhe një herë diskutimet për legalizimin e shtesave pa leje, të cilat vlerësohen si të konsiderueshme, përderisa nevojitet një ligj i posaçëm për trajtimin e tyre.

B. Rreziqet Substanciale

B.1 Objektivat e ligjit²⁸ – Objektivat e ligjit parashikohen në dispozitat e përgjithshme të tij, të titulluara, si: “objekti”, “qëllimi”, ndërkohë një përshkrim më i detajuar i objektivave jepet në relacionin shoqëruar të projektligjit, i cili duhet të përshkruajë problemin, që synon të zgjidhë projektligji i ri, një vlerësim të gjendjes faktike dhe të argumentojë, që pse një projektligj i ri është zgjidhja e duhur për atë çështje të krijuar.

- Ligji i ri parashikon si qëllime të tij primare rregullimin dhe zbutjen e pasojave sociale e urbane të shkaktuara nga ndërtimet për qëllim fitimi në kundërshtim me ligjin, si dhe mirëadministrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim. Por parashikimet e detajuara në nenet e titulluara “Objekti” dhe “Qëllimi” nuk përputhen me dispozitat e tjera vijuese, ku thelbi i tyre është “Programi i shitjes së objekteve të konfiskuara”, ku gëzojnë të drejtën e parablerjes pronarët e truallit për pjesën e takuese të tyre, personat e tretë që kanë lidhur kontrata paraprake tek noteri për pjesën e konfiskuar dhe nëse dy subjektet më lart shprehen me shkrim se nuk duan ta ushtrojnë këtë të drejtë apo nuk përgjigjen brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit, atëherë këtë të drejtë e ushtron subjekti zhvillues/ ndërtues, pra kundërvajtësi, ai që ka bërë ndërtimin pa leje.

B.2 Procedurat²⁹ - Procedura është e parashikuar në ligj. I është lënë një hapësirë e madhe diskrecionare Komisionit të Objekteve të Konfiskuara se kur dhe në cilat raste mund të vendosë që një objekt i konfiskuar të kalojë për shitje dhe të mos përdoret për interes publik. Kjo hapësirë e madhe diskrecionare lë vend për korrupsion, pasi varësisht subjekteve që kanë kryer shkeljen dhe që duan ta rifitojnë pronësinë mbi objektin e konfiskuara mund të jetë edhe vendimmarrja e Komisionit. Pra në këtë rast kjo dispozitë duhej të ishte shumë e detajuar dhe jo siç është formuluar.

²⁷ A.2.1. A ka dispozita kontradiktore brenda ligjit? A ka dispozita kontradiktore me ligjet e tjera? A.2.2 A është terminologjia e përdorur e saktë dhe konsistente? A.2.3 A janë referencat e sakta dhe të qarta brenda ligjit? A janë referencat e sakta dhe të qarta tek ligjet e tjera? A.2.4 A i mbulon teksti i ligjit të gjitha çështjet? A ekziston ndonjë vakuum ligjor?

²⁸ B.1.1 A është kryer vlerësimi paraprak dhe a është i saktë? A janë përcaktuar objektivat e ligjit në përputhje me vlerësimin paraprak? B.1.2 Rregullat e hartuara të ligjit a janë koherente me objektivat e ligjit?

²⁹ B.2.1 A është përcaktuar diskrecioni në masën e duhur, që të mos jetë i gjerë? A ka kritere që përcaktojnë diskrecionin? A ka diskrecion për të zbatuar përjashtimin nga rregulli? B.2.2 A ka diskrecion rregullator? B.2.4 A është e qartë procedura e përcaktuar? B.2.5 A është e thjeshtë procedura, pa pengesa të tejskajshme? B.2.6 A sigurohet akses i duhur në informacion gjatë procedurës? B.2.7 A janë caktuar afate për hapat proceduralë? A janë të sakta dhe të përshtatshme afatet? B.2.8 A garanton konkurrencën e lirë procedura, nëse vendos rregulla përzgjedhëse? B.2.9 A është e qartë procedura e vendimmarrjes? A janë kriteret e qarta për vendimmarrje?

B.3 Organi zbatues³⁰

- Në ligj janë caktuar autoritetet shtetërore përgjegjëse si: Këshilli i Ministrave, Komisioni i Objekteve të Konfiskuara, ministria përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, si dhe njësia e zbatimit të programit të zhvillimit.

B.4 Mbikëqyrja³¹

Nuk është përcaktuar një institucion për të mbikëqyrur të gjithë procesin, por duke qenë se Këshilli i Ministrave (neni 9 i ligjit) është renditur në krye të autoriteteve përgjegjëse, si dhe i janë caktuar kompetenca të posacme miratuese për kalimin e objekteve të konfiskuara apo fondeve përkatëse, atëherë mbikëqyrja e të gjithë procesit kryhet nga ky organ kolegjal apo nga organi që caktohet me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

B.5 Sanksionet³²

Në ligj nuk ka një dispozitë me sanksione. Siç e kemi shpjeguar më lart, ky ligj mund të ishte pjesë e ligjit nr. 107/ 2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, pasi përcakton rregullat sesi do të administrohen dhe përdoren objektet e konfiskuara si ndërtime pa leje, që janë si derivat i zbatimit të ligjit nr. 107/ 2014.

B.6 Kontrolli gjyqësor³³

Subjektet e përfshira në fushën që rregullohet nga ky ligj e kanë mundësinë që t'i drejtohen autoriteteve gjyqësore në rast cënimi të të drejtave të tyre. Kjo e drejtë nuk është parashikuar në këtë ligj, por rrjedh nga Kushtetuta dhe nga legjislacioni në fuqi. Situatat që mund të krijohen gjatë zbatimit të këtij ligji janë nga më të ndryshmet, p.sh: subjekti të cilit i është konfiskuar një ndërtim, si pa leje ndërtimi mund të ankohet, nëse ai ka qenë i pajisur me leje dhe e ka zbatuar me rigorozitet atë, mund të ankohen po ashtu pronarët e truallit nëse nuk zbatohet kontrata e lidhur me ndërtuesin, apo nuk respektohen të drejtat që atyre u njeh ky ligj i ri, mund të ankohen po ashtu edhe palët e treta, që kanë lidhur një kontratë për objektin e konfiskuar përpara se të konstatohej paligjshmëria e tij, për rastet kur nuk iu respektohen të drejtat që iu njihen nga ky ligj.

Konkluzione në lidhje me ligjin e analizuar më lart

³⁰ B.3.1 A është caktuar një organ kompetent për zbatimin e ligjit apo të aktit nënligjor? B.3.2 A janë caktuar qartë kompetencat e organit? A ka mbivendosje kompetencash? B.3.3 Nëse organi zbatues është deleguar të rregullohet me akt nënligjor, a është caktuar një afat për nxjerrjen e organit nënligjor? A ka rrezik për ngritjen e vonuar të organit? B.3.4 A është parashikuar më shumë se një organ për zbatimin e ligjit? A janë koherente kompetencat e tyre? A është e qartë se cili është organi kryesor përgjegjës? B.3.5 A respektojnë rregullat e hartuara standardet e parandalimit dhe të shmangies së konfliktit të interesave?

³¹ B.4.1 A parashikon ligji një mekanizëm mbikëqyrës? B.4.2 A garanton ligji transparencë të zbatimit të tij?

³² B.5.1 A përcakton ligji sanksione në rast të shkeljes së detyrimeve? B.5.2 A janë sanksionet proporcionale?

³³ B.6.1 A parashikon ligji kontrollin gjyqësor të veprimtarisë administrative? B.6.2 Rregullat për kontrollin gjyqësor a janë formuluar qartë?

- 1) Ligji mund të rikonceptohet si shtesë në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, duke trajtuar më vete se në cilat raste shumë të rralla mund të lihet pa u prishur/shembur shtesa pa leje. Kushtet në të cilat ajo mund të konfiskohej dhe të trajtohej vetëm për interes publik, por jo për t’iu shitur sërish subjektit ndërtues që ka kryer kundërvajtjen në ndërtim.
- 2) Nëse ky ligj merr fuqi të plotë, duke u miratuar edhe aktet nënligjore në zbatim të tij, atëherë krijohet një skemë e gatshme mashtrimi, ku shoqëritë ndërtuese lejohen të ndërtojnë volume apo sipërfaqe shtesë pa leje (pa paguar taksat përkatëse mbi lejen e ndërtimit dhe të zhvillimit, etj) dhe në përfundim ata i riblejnë duke u pajisur me lejet përkatëse *post factum*.

4. Roli i aktorëve të sistemit parlamentar në mbikqyrjen efektive të fushës së financimeve të paligjshme në Shqipëri

4.1 Analizë e situatës

Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave është përgjegjës për përcaktimin e drejtimeve të politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave e financimit të terrorizmit. Komiteti drejtohet nga Kryeministri dhe në përbërje ka ministrin përgjegjës për financat, ministrin përgjegjës për punët e jashtme, ministrin përgjegjës për çështjet e mbrojtjes, ministrin përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ministrin përgjegjës për çështjet e drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit, Inspektorin e Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Komiteti mbledhet të paktën 1 herë në vit për të shqyrtuar dhe analizuar raportet për veprimtaritë e kryera nga autoriteti përgjegjës, si dhe raportet për dokumentet e përgatitura nga institucionet dhe organizmat ndërkombëtarë, të cilat ushtrojnë veprimtaritë e tyre në fushën e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Drejtori i përgjithshëm i autoritetit përgjegjës i ofron komitetit, sipas kërkesës së tij dhe vepron si këshilltar në mbledhjet e këtij komiteti. **Në mbledhjet e komitetit mund të ftohen për të marrë pjesë ministra, deputetë, drejtues ose përfaqësues të institucioneve dhe ekspertë në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave e financimit të terrorizmit.**

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ushtron funksionet e autoritetit përgjegjës, si një institucion në varësi të Ministrisë të Financave. Kjo drejtori, brenda fushës së veprimtarisë së vet, ka të drejtë të vendosë për mënyrën e ndjekjes dhe të zgjidhjes së çështjeve të trajtuara për pastrimin e mundshëm të parave dhe financimin e veprimtarive të mundshme terroriste. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave shërben si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjithashtu, kjo drejtori funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Banka e Shqipërisë është autoritet mbikqyrës për subjektet e përcaktuara, nga shkronjat nga “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të nenit 3 të këtij ligji;

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është autoritet mbikqyrës për subjektet e përcaktuara në shkronjat “e”, “ë” dhe “j”, të nenit 3, të këtij ligji;

Ministritë dhe/ose autoritetet përkatëse për mbikëqyrjen e subjekteve të përcaktuara në shkronjat “f”, “g”, “gj”, “h”, “i”, “k” dhe “l”, të nenit 3, të këtij ligji;

Dhoma Kombëtare e Avokatisë për mbikëqyrjen e avokatëve dhe **Ministria e Drejtësisë** për mbikëqyrjen e noterëve.

4.2 Mbi përvojat perendimore në fushen e taksimit të lojrave të fatit online

Pranohet gjerësisht se sektori i lojërave të fatit karakterizohet nga një rritje e shpejtë ekonomike dhe zhvillim teknologjik, me rritje të fortë të sektorit online gjatë dhe pas pandemisë Covid-19. Vende të ndryshme ngarkojnë tarifa të ndryshme tatimore, të cilat ose mund të inkurajojnë ose të shtyjnë lojrat e fatit në internet që të hapen atje.³⁴ Greqia ka një nga normat më të larta të taksave me 35%.³⁵

Qeveria Holandeze ngarkon gjithashtu një normë më të lartë tatimore për kazinotë - 29%.³⁶ Për më tepër, operatorët e kazinove në internet duhet të kontribuojnë me 1.5% në autoritetin e lojërave - ekuivalenti i vendit me blerjen e një licence - si dhe të lënë mënjanë 0.25% për të shkuar në fondin e vendit për luftimin e varësisë.

Italia mban pjesën e dytë më të madhe të tregut evropian të lojërave të fatit në internet – pas Britanisë së Madhe – dhe tarifon një mesatare prej 22% për kazinotë.³⁷

Suedia është një tjetër lojtar kryesor, dhe ata përsëri ndjekin një sistem të shitjes së licencave dhe ngarkimit të një shume të arsyeshme tatimi; kësaj radhe 18%.³⁸

Një qasje krejtësisht e ndryshme është marrë nga Republika Çeke, me qeverinë që operon një sistem të ndryshëm taksash, në varësi të mënyrës se si sigurohen fitimet. Për shembull, operatorët e basteve sportive, qofshin ato në Internet ose me bazë tokësore, do të duhet të paguajnë 23%, megjithatë, cilitdo që dëshiron të përdorë makinat e fatit i nënshtrohet një takse masive prej 35% mbi të ardhurat e siguruara. Qeveria ka marrë gjithashtu masa ekstreme për të parandaluar që njerëzit të gjenden në vështirësi financiare, cilitdo që merr ndihmë financiare nga qeveria i ndalohet të luajë kumar.

Vendet e ndryshme Europiane, në rregullimin e këtij tregu, kanë përcaktuar edhe objektiva, ndër të cilat mund të përmendim:

UK

- Parandaloni që kumari të jetë një burim krimi ose çrregullimi.
- Sigurohuni që lojërat e fatit të zhvillohen në mënyrë të drejtë dhe të hapur.

³⁴ Auer, M., & Griffiths, M. D. (2022). Gambling before and during the COVID-19 pandemic among online casino gamblers: An empirical study using behavioral tracking data. *International Journal of Mental Health and Addiction*, 20(3), 1722-1732.

³⁵ Marrë nga <https://igamingbusiness.com/finance/greece-approves-fixed-35-tax-rate-for-online-gaming-operators/>.

³⁶ Marrë nga <https://iclg.com/practice-areas/gambling-laws-and-regulations/netherlands#:~:text=Since%201%20October%202021%2C%20remote,currently%20been%20set%20at%2029.5%25>.

³⁷ Marrë nga <https://www.affiversemedia.com/italy-approves-turnover-tax-for-gambling-operators/>.

³⁸ Marrë nga [https://igamingbusiness.com/legal-compliance/legal/atg-flags-alarming-increase-in-illegal-swedish-gambling/#:~:text=Sweden's%20government%20\(Regeringen\)%20in%20September,Sweden%20from%201%20July%202024](https://igamingbusiness.com/legal-compliance/legal/atg-flags-alarming-increase-in-illegal-swedish-gambling/#:~:text=Sweden's%20government%20(Regeringen)%20in%20September,Sweden%20from%201%20July%202024).

- Mbroni fëmijët dhe personat e tjerë të cenueshëm nga dëmtimi ose shfrytëzimi nga lojërat e fatit.

Italia:

- Operatorët e lojërave të fatit në internet duhet të kenë një prani fizike në Itali ose në një vend tjetër të BE-së dhe duhet të përdorin një emër domaini.it për faqen e tyre të Internetit.
- Operatorët e lojërave të fatit në Internet duhet të paguajnë një taksë prej 20% mbi të ardhurat e tyre bruto nga lojërat e fatit dhe duhet të kontribuojnë në një fond për parandalimin dhe trajtimin e varësisë ndaj lojërave të fatit.
- Lojtarët e lojërave të fatit në Internet duhet të jenë të paktën 18 vjeç dhe duhet të regjistrohen me një dokument identiteti të vlefshëm dhe kod tatimor. Ata gjithashtu duhet të vendosin një kufi maksimal të shpenzimeve dhe të respektojnë sistemin e vetëpërrjashtimit.

Gjermania:

- Lojërat e kazinosë në Internet, pokeri dhe automatet virtuale janë të ligjshme dhe i nënshtrohen licencimit dhe taksimit.
- Bastet sportive online janë gjithashtu të ligjshme dhe i nënshtrohen licencimit dhe taksave, por operatorët duhet të respektojnë disa kufizime për llojet dhe sasinë e basteve që mund të ofrojnë.
- Operatorët e lojërave të fatit në Internet duhet të zbatojnë masa për të siguruar kumar të përgjegjshëm, të tilla si vendosja e kufijve të depozitave, ofrimi i opsioneve të vetëpërrjashtimit dhe shfaqja e paralajmërimeve dhe informacionit mbi rreziqet e lojërave të fatit.

Spanja:

- Lojërat e fatit në internet të zhvillohen në mënyrë të sigurt, të përgjegjshme dhe transparente, duke mbrojtur të drejtat dhe interesat e klientëve dhe duke parandaluar mashtrimin dhe pastrimin e parave. Operatorët e lojërave të fatit në internet duhet të respektojnë kërkesat ligjore dhe teknike të përcaktuara nga autoriteti përgjegjës shtetëror, si dhe të paguajnë taksa mbi të ardhurat e tyre bruto nga lojërat.

Franca:

- Moshë ligjore për të marrë pjesë në lojërat e fatit: Banorët francezë mund të regjistrohen dhe të vendosin baste me para reale në internet për sa kohë që janë të paktën 18 vjeç.
- Instrumentet bankare të miratuara: Bilanci i lojtarëve nga Franca mund të financohet vetëm me instrumente të caktuara bankare të miratuara, të tilla si karta krediti, transfertat bankare ose karta të parapaguara. Kriptovalutat nuk lejohen.

- Përmbartimi i borxheve të lidhura me lojërat e fatit: Borxhet që rezultojnë nga aktivitetet e lidhura me lojërat e fatit nuk janë të detyrueshme në Francë. Kjo do thotë që lojtarët nuk mund të padisin operatorët ose lojtarët e tjerë për të rikuperuar humbjet e tyre.

Në vitin 2022, 28 vendet anëtare të BE-së (duke përfshirë edhe UK) raportojnë se kishin një nivel të informalitetit në ekonomi prej 17,3%, me një rritje prej 1% kundrejt vitit 2019.³⁹

Ndërkaq, vihet re se pjesa e tregut të lojërave të fatit në Internet po rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe pritet të arrijë në 33.6% të të ardhurave bruto të Evropës nga lojërat deri në vitin 2025. Dmth 1 ne 3 Euro që qarkullojnë ne lojrat e fatit vjen nga lojrat ne Internet.

Në vitin 2019, Evropa kishte një normë kanalizimi të tregut të lojërave të fatit në Internet prej 73.5%, që do të thotë se gati tre të katërtat e aktivitetit të lojërave të fatit në internet u zhvilluan në tregun e rregulluar, ndërsa 26.5% e aktivitetit u zhvillua në tregjet gri dhe të zeza. Dmth me shume se 1/4 e parave të qarkulluara ne kete treg (lojrat e fatit ne Internet) është pjesë e ekonomise informale dhe kriminale (shih: <https://voluum.com/blog/online-gambling-eu-uk/>)

Duke marrë parasysh nivelin e lartë të informalitetit në ekonominë tonë kombëtare, të paktën 3 herë më të lartë se në vendet e BE-së (mbi 50%) merret me mend se çfarë letësish të mëdha do të krijojë miratimi i këtij ligji mbas pak ditësh në versionin e paraqitur për miratim për rritjen e informalitetit dhe vecanësisht për grupet kriminale të interesuara.

³⁹ Parlamenti Europian. (2022). "Tatimi i ekonomisë informale". Marrë nga [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2022/734007/IPOL_STU\(2022\)734007_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2022/734007/IPOL_STU(2022)734007_EN.pdf).

5. Konkluzione dhe Rekomandime

Ky dokument pune, gjatë analizës, ka ofruar një sërë gjetjesh dhe rekomandimesh respektive. Në këtë seksion, paraqiten disa rekomandime të përgjithshme, të cilat vlerësohen si sugjerime për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe të klimës në përgjithësi në lidhje me financimet e paligjshme.

- Shtimi i informacioneve në relacion: Relacioni duhet të shtohet me të dhëna shtesë në lidhje me gjendjen faktike në fushën e lojërave të fatit, veçanërisht për volumin e qarkullimit në këtë treg. Është e rëndësishme të përfshihet arsyetimi për vendimin e munguar për mbylljen e tregut të lojërave të fatit vetëm pesë vite më parë.
- Përmirësim i Projekt-Ligjit: Projekt-ligji duhet të përmirësohet në disa aspekte, përfshirë masat për të parandaluar trukimin e ndeshjeve sportive dhe krijimin e skemave mashtruese me lojërat e fatit. Është e rekomandueshme të përfshihen përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në komisionin e licencimit. Kjo do të sigurojë kontroll më të fortë në aspektin e parandalimit të pastrimit të parave.
- Dëgjesat me Grupet Vulnerabël: Është e rëndësishme që në Komisionet Parlamentare të organizohen dëgjesa me përfaqësues të grupeve vulnerable, të cilat kanë vuajtur nga varësia e lojërave të fatit. Këto dëgjesa mund të ndihmojnë në kuptimin e nevojave të tyre dhe pasojave sociale të kësaj varësie.
- Krijimi i një fondi të mbështetjes për të ndihmuar viktimat e varësisë nga lojërat e fatit dhe për rehabilitimin e tyre, me kontributin e drejtpërdrejtë të kompanive që do të licencohen.
- Dëgjesat me Dhomat e Huaja të Tregtisë: Është e rekomandueshme të organizohen dëgjesa edhe me përfaqësues të dhomave të huaja të tregtisë për të vlerësuar nëse kriteret e përcaktuara për subjektet aplikuese janë të arritshme dhe jo diskriminuese për bizneset anëtare të tyre. Kjo do të ndihmojë në sigurimin e një ndërlidhjeje të qëndrueshme me komunitetin ndërkombëtar të biznesit.
- Sugjerohet që Kuvendi, për çdo projektligj të ri, i cili rregullon marrëdhëniet juridike në fusha sensitive, që mund të përdoren për pastrimin e parave, të përpiqet të shtojë parashikimet ligjore që garantojnë transparencën e fondeve të përdorura nga subjektet, si dhe kontrollet e efektshme e periodike në atë fushë.

Në lidhje me zbatimin e deritanishëm të legjislacionit në fushën e administrimit⁴⁰ të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, nisur nga parashikimet ligjore, si dhe nga praktika⁴¹ e deritanishme në fushën e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në mënyrë që të rritet efektshmëria e përdorimit të tyre, por edhe të shmanget në maksimum rreziku, që ato pasuri të përfundojnë sërish në duart e krimit do të sugjerohet si vijon:

- Përdorimi i kërtre pasurive të jetë kryesisht:
 - a) për dëmshpërblimin e viktimave të krimit (të rritet roli i viktimave në procesin penal e kësajsoj ato përfitojnë edhe dëmshpërblimin nga këto pasuri);

⁴⁰ Faqe zyrtare e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK). <https://aapsk.gov.al/rreth-aapsk/>.

⁴¹ Shih edhe raportin e KLSH-sw mbi veprimtarinë e AAPSK. Marrë nga - chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgiclfndmkaj/https://panel.klsh.org.al/storage/phpPvGELw.pdf.

- b) për ngritjen e ndërmarrjeve sociale me fokus zonat e prapambetura apo grupet e marginalizuara të shoqërisë;
 - c) t'u kalohen në përdorim institucioneve shtetërore apo bashkive për t'i përdorur vetëm për interes publik dhe jo për t'i shitur apo dhënë me qira;
 - d) në raste shumë të rralla, me miratimin e Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar mund të kalohen për shitje, por duke e shpallur argumentimin pse propozohet të veprohet kështu.
- Të rritet transparenca e veprimeve të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, ku informacionet që jepen në ëebpage-in e saj të jenë të ndara sipas qyteteve, database-i të pasurohet me të dhënat e subjektit, që e përdor atë pasuri, afatin e kontratës përkatëse, etj.

Bibliografia

- Affiverse Media. (s.f.). "Italia miraton tatimin mbi vëllimin për operatorët e lojërave të fatit." Marrë nga <https://www.affiversemedia.com/italy-approves-turnover-tax-for-gambling-operators/>.
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) - Raporti Vjetor: <https://www.aida.gov.al/sq/aida/raport-vjetor>.
- Auer, M., & Griffiths, M. D. (2022). "Lojërat e fatit para dhe gjatë pandemisë COVID-19: një studim empirik."
- Dokumenti "Guide 2023" nga Partners Albania: <https://www.partnersalbania.org/wp-content/uploads/2023/09/guide-2023.pdf>.
- Financial Action Task Force (FATF) - Faqja Zyrtare. <https://www.fatf-gafi.org/en/the-fatf/who-we-are.html>.
- I-gaming Business. (2022). "Greqia miraton normën e tatimit fiks prej 35% për operatorët e lojërave të fatit online." Marrë nga <https://igamingbusiness.com/finance/greece-approves-fixed-35-tax-rate-for-online-gaming-operators/>.
- I-gaming Business. (s.f.). "ATG shënon një rritje të lojërave të fatit ilegale në Suedi." Marrë nga [https://igamingbusiness.com/legal-compliance/legal/atg-flags-alarming-increase-in-illegal-swedish-gambling/#:~:text=Sweden's%20government%20\(Regeringen\)%20in%20September,Sweden%20from%201%20July%202024](https://igamingbusiness.com/legal-compliance/legal/atg-flags-alarming-increase-in-illegal-swedish-gambling/#:~:text=Sweden's%20government%20(Regeringen)%20in%20September,Sweden%20from%201%20July%202024).
- Indeksi Basel kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2022 - Instituti Basel për Qeverisjen. <https://baselgovernance.org/publications/basel-aml-index-2022>.
- Iniciativa Globale "Prurje Financiare të Paligjshme në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut: Faktorët Kryesorë dhe Prirjet Aktuale", 2020. <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/08/Prurje-Financiare-Te%CC%88-Paligjshme-Ne%CC%88-Shqipe%CC%88ri-Kosove%CC%88-Dhe-Maqedonine%CC%88-E-Veriut-Faktore%CC%88t-Kryesore%CC%88-Dhe-Prirjet-Aktuale.pdf>.
- Instituti Basel për Qeverisjen. <https://baselgovernance.org/>.
- International Comparative Legal Guides. (s.f.). "Netherlands: Që nga 1 tetori 2021, norma e tatimit për lojërat e fatit në distancë është 29.5%." Marrë nga

<https://iclg.com/practice-areas/gambling-laws-and-regulations/netherlands#:~:text=Since%201%20October%202021%2C%20remotely%20been%20set%20at%2029.5%25.>

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – Albania. <https://kqz.gov.al/monitoruesit-audituesit/>.
- Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) - Raporti mbi Veprimtarinë e AAPSK-së. <https://panel.klsh.org.al/storage/phpPvGELw.pdf>.
- Parlamenti Shqiptar - Dokumentacioni: "Aktet". <https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/11791441-855b-4d61-a1aa-9ef28190ac7a>.
- Raporti i Departamentit të Shtetit të SHBA-së për vitin 2023, "Investment Climate Statements - Albania". <https://www.state.gov/reports/2023-investment-climate-statements/albania/>.
- Rekomandimet Speciale FATF. <https://www.fatf-gafi.org/en/publications/Fatfrecommendations/lxspecialrecommendations.html>.